



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

**AD.nr.2/2022**

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**, U.D. Kryetari i Gjykatës Artan Sejrani, në çështjen e hetimit disiplinor, duke vepruar sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 21.02.2022 e parashtruar nga B.S., nga Prizreni, ndaj gjyqtari A.B., me datë **16.03.2022** mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pa bazuar** kërkesa e B.S., nga Prizreni e parashtruar me datën 21.02.2022, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B.,.

### **A r s y e t i m**

Parashtruesja e kërkesës B.S., nga Prizreni me datën 21.02.2022 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B.; në kërkesën e saj ka theksuar se me datën 27.07.2021 ka bërë padinë për kthimin e gjësendeve personale me masë të përkohshme të sigurisë pranë Gjykatës Themelore në Prizren dhe e njëjta lëndë i ka rënë gjyqtarit A.B.. Arsyeja se pse po e parashtron ankesën ndaj gjyqtarit në fjalë është fakti se i njëjti nuk ka vendosur lidhur me masën e përkohshme të sigurisë që nga dita kur e ka dorëzuar padinë për kthimin e gjësendeve nga data 27.07.2021 e që për vendosjen sipas masës së përkohshme është afati prej 3 ditë pune. Duke propozuar që ndaj gjyqtarit A.B., të iniciohet procedura disiplinore.

Gjyqtari A.B., në deklaratën e tij me shkrim ka theksuar se lënda është pranuar me datën 27.07.2021 dhe është lëndë e re dhe nuk hynë në grupin e lëndëve që kanë prioritet. Është e vërtetë që pala së bashku me padi ka paraqitur edhe kërkesën për masën e përkohshme të sigurimit duke kërkuar që të paditurit ti ndalohet të mos i ngarkojë fsheh apo tjetërsojë dhe ka kërkuar kthimin e sendeve. Pasi që me kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit është kërkuar kthimi i sendeve kërkesë që është e njëjtë me kërkesën nga padia përkatësisht petitumi i padisë ka vlerësuar që të mos vendos për masën pasi që në të dy rastet si e miratova si e refuzova do të prejudioja çështjen kryesore. Ka sqaruar se duke pas parasysh se me propozimin për caktimin e masës së përkohshme prejudiohet çështja kryesore ka vendosur për masën e përkohshme të sigurimit aq më tepër pasi që në kuptim të nenit 300 të LPK-së masa e përkohshme e sigurimit mund të vendoset nëse plotësohen kushtet dhe çfarë është shumë më rëndësi në rast se gjykata miraton kërkesën për masën e përkohshme të sigurimit germa (a) e par. 1 të nenit 300 kërkon që ai ndalim të regjistrohet në regjistra publik. Pikërisht neni 300 lidhur me nenin 297 të LPK-së i lë në diskrecion gjyqtarit të vendos ose jo për masë. Formulimi i ligjit është i tillë që do të thotë që gjykata mund të vendos. Nuk kërkojnë detyrimisht që gjykata duhet të vendos për masën e kërkuar.

U.D. Kryetari i Gjykatës pas hetimit paraprak, shikimit në shkresat e lëndës penale C.nr. ...., analizimit të kërkesës së parashtrueses, deklaratës së gjyqtarit të çështjes, konstaton se kërkesa është e pa bazuar.

U.D. Kryetari i gjykatës fillimisht konstaton parashtruesja kërkesës në këtë lëndë është në cilësi të paditëses sipas padisë, për shkak të kthimit të gjësendeve personale ndaj të paditurit R.O., Gjyqtari i çështjes lëndën në fjalë e ka pranuar me datën 27.07.2021. Pra, lënda është e vitit 2021.

U.D. Kryetari i gjykatës lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë, në ankesën e saj parashtruesja ka theksuar se gjyqtari i çështjes A.B., nuk ka vendosur sipas kërkesës për masë të përkohshme e parashtruar me datën 27.07.2021. Në fakt U.D., Kryetari i Gjykatës vlerëson se me nenin 297, 298, 299, 300, 301, 306 të LPK-së në lidhje me masat për sigurimin e kërkesëpadisë është përcaktuar alternativa "mund" në rastin e caktimit të këtyre masave nga ana Gjykatës po ashtu në lidhje me masat e sigurimit të kërkesëpadisë nuk parashikohet obligimi i Gjykatës për të vepruar brenda ndonjë afati të caktuar por megjithëse këto masa janë të natyrës urgjente rrjedh edhe obligimi për trajtimin e masave në afat të arsyeshëm kohor. Megjithatë nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se kërkesa për caktimin e masës së përkohshme e kërkuar nga paditësja është e njëjtë me kërkesëpadinë dhe në çdo rast nëse do të vendosej për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë do të zgjidhej edhe çështja kryesore paraprakisht. Po ashtu edhe pretendimet tjera të parashtrueses janë të pa bazuara sepse në rastin konkret lënda është e vitit 2021 dhe nuk hynë në radhën e lëndëve që kanë prioritet për trajtim.

U.D. Kryetari i Gjykatës i rikujton se në lidhje e ankesat e palëve kufizohet vetëm në shkaqet e përcaktuara sipas ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërsa nuk mund ti shqyrtoj veprimet procedurale dhe vendimet e gjyqtarit sepse të njëjtat mund të jenë objekt i shqyrtimit të performancës apo edhe të organeve tjera sipas mjeteve juridike.

Andaj siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 9 par.6 lidhur me nenin 17 par.5 të ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

## GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD.nr.2/2022 datë 16.03.2022

16.03.2022



U.D. Kryetari i Gjykatës  
Artan Sejrani

**Kundër këtij aktvendimi nuk parashihet e drejta e ankesës.**